

Lejet e ndërtimit

Tremujori IV, 2019


Tiranë, më 28 Shkurt 2020: Në tremujorin e katërt 2019 janë miratuar gjithsej 196 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 360 leje të miratuara në tremujorin e katërt 2018, duke shënuar një rënie prej 45,6 %.

Gjatë vitit 2019, janë miratuar gjithsej 1.044 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 1.194 leje të miratuara në vitin 2018, duke shënuar një rënie prej 12,6 %.

Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja, në tremujorin e katërt 2019, është 240.480 m², nga 618.219 m² miratuar në tremujorin e katërt 2018, duke shënuar një rënie prej 61,1 %. Në tremujorin e katërt 2019, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 11,7 miliardë lekë, nga 22,1 miliardë lekë miratuar në tremujorin e katërt 2018, duke shënuar një rënie prej 47,1 %.

Gjatë vitit 2019, sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja është 1.916.719 m², nga 1.442.783 m² miratuar në vitin 2018, duke shënuar një rritje prej 32,8 %. Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 79,3 miliardë lekë në vitin 2019, nga 59 miliardë lekë miratuar gjatë vitit 2018, duke shënuar një rritje prej 34,4 %.

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit, 2019 (%)



Tab.1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T4 - 2019

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m ²	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
Gjithsej			9.586.684	2.117.892
I. Ndërtesa	196	240.480	8.245.865	1.230.171
1.Ndërtime për banim (rezidente)	139	170.778	6.419.997	245.830
a. Me një kat	34	5.066	156.743	129.480
b. Me dy kate	66	12.362	382.219	101.468
c. Me tre ose më shumë kate	34	142.290	5.492.672	12.863
d. Rezidenca për komunitetet	5	11.060	388.363	2.019
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	57	69.702	1.825.868	984.341
a. Hotele dhe të ngjashme	12	20.803	811.997	41.460
b. Ndërtesa për zyra	0	0	0	28.319
c. Ndërtesa tregtare	16	6.673	143.743	48.047
d. Ndërtesa industriale	19	36.546	672.022	326.722
e. Ndërtesa të tjera	10	5.680	198.106	539.793
II. Punime inxhinierike			1.340.819	887.721
1. Infrastruktura e transportit; Rrugë e autostrada			0	588.594
2. Linjat e ujësjellësve,elektrike dhe telekomunikacionit			1.034.980	280.276
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			0	0
4. Punime të tjera inxhinierike			305.839	18.851

* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV - 18	I - 19	II - 19	III - 19	IV - 19
Shqipëria	360	245	310	293	196
Berat	12	7	6	4	1
Dibër	5	1	2	12	3
Durrës	44	26	55	48	23
Elbasan	29	24	29	21	23
Fier	30	20	20	35	23
Gjirokastrë	16	8	7	4	1
Korçë	35	17	22	18	24
Kukës	3	1	6	5	0
Lezhë	19	24	10	16	15
Shkodër	29	8	24	4	16
Tiranë	120	94	111	108	60
Vlorë	18	15	18	18	7

* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

** Në informacionin e qarikut Tiranë, mungojnë të dhënat mbi bashkinë Kamëz për tremujorin e dytë, tremujorin e tretë dhe tremujorin e katërt 2019.

Tab.3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV - 18	I - 19	II - 19	III - 19	IV - 19
Shqipëria	618.219	581.236	409.548	685.455	240.480
Berat	13.571	3.089	1.856	1.448	98
Dibër	1.189	681	503	5.993	557
Durrës	47.154	21.580	60.708	34.685	19.422
Elbasan	16.978	18.836	11.847	8.410	5.725
Fier	6.572	14.062	6.928	18.597	8.129
Gjirokastër	6.520	1.448	8.168	1.492	134
Korçë	20.380	4.182	11.322	7.238	10.759
Kukës	740	359	4.423	4.836	0
Lezhë	14.585	26.567	6.062	36.408	32.025
Shkodër	26.211	2.543	11.514	713	3.075
Tiranë	456.480	479.954	273.133	556.848	146.893
Vlorë	7.839	7.935	13.084	8.787	13.663

* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

** Në informacionin e qarkut Tiranë, mungojnë të dhënat mbi bashkinë Kamëz për tremujorin e dytë, tremujorin e tretë dhe tremujorin e katërt 2019.

Tab.4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Qarqet	IV - 18	I - 19	II - 19	III - 19	IV - 19
Shqipëria	22.140.540	25.216.754	16.792.172	25.600.331	11.704.576
Berat	584.440	215.209	301.059	83.304	224.810
Dibër	87.914	22.863	84.834	366.053	159.184
Durrës	2.093.900	692.523	2.309.790	1.190.215	602.812
Elbasan	599.773	1.034.810	1.050.083	802.368	354.759
Fier	1.354.519	931.316	807.316	1.071.093	1.403.325
Gjirokastër	333.949	222.707	274.051	133.463	17.896
Korçë	853.060	455.475	440.280	252.804	483.100
Kukës	34.626	11.800	195.183	222.348	0
Lezhë	495.780	2.862.205	277.277	664.846	964.939
Shkodër	1.039.427	735.623	421.698	1.065.159	895.028
Tiranë	14.329.332	17.678.507	9.880.140	18.607.334	5.601.147
Vlorë	333.820	353.716	750.461	1.141.344	997.576

* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstruksioneve.

** Në informacionin e qarkut Tiranë, mungojnë të dhënat mbi bashkinë Kamëz për tremujorin e dytë, tremujorin e tretë dhe tremujorin e katërt 2019.

Metodologjia

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

Punime Inxhinierike janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.